

URDHËR
Nr. 720, datë 1.11.2018

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 673, datë 22.11.2017, “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, të ndryshuar; të nenit 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit te z. Daniel Shima, zëvendësdyrëtor i përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, për nënshkrimin e akteve, për sa më poshtë vijojnë:

- Korrespondenca me institucionet dhe organet e administratës shtetërore, mbi ngritjen e grupeve të punës apo të grupeve të përbashkëta të punës, si dhe ngritja e këtyre grupeve me qëllim zbatimin efektiv dhe bashkërendimin e projekteve për analizimin, ngritjen, mirëmbajtjen dhe administrimin e sistemeve dhe të aplikacioneve të teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit, për infrastrukturën e qendëruar dhe infrastrukturën TIK.

- Procedura e rekrutimit të punonjësve, si dhe ndjekja e korrespondencës me institucionet dhe organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, lidhur me kalimin e njësive të teknologjisë së informacionit prej tyre pranë AKSHI-it.

2. Data e fillimit të kompetencave të deleguara është data e hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

3. Delegimi i kompetencave mbaron me revokimin e aktit të delegimit.

4. Ngarkohet me zbatimin e këtij urdhri zëvendësdyrëtori i përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit.

5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM
Mirlinda Karçanaj